



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr. Serie 16

LEJE
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR

Nr. prot. 10 / datë 22/04/2020
13

Miratuar me :
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR
Nr. 03, datë 16/04/2020

Emri i subjektit: "Kurum International" sh.a
I REGJISTRUAR ME KËTO TË DHËNA: "KURUM INTERNATIONAL" SH.A, me
NIPT **K02727230T**

Baseni Ujor: **VJOSË**
Qarku: **VLORË**

Bashkia/Komuna: **FINIQ**

Koordinatat: **X 508994 Y 4419765 Z 54.75**

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **Prodhim Hidroenergjie**

Prurja mesatare: **18.3 m3/s**

Prurja ekologjike: **0.5 m3/s**

Sasia e ujit që jepet në përdorim: **25 m3/s**

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) : **25 m3/s** dhe vendi ku rrjedha e kthyer do të
shkarkohet : Lumi Bistrica

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Lumi Bistrica

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): **s'ka** (ha)

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë : Të menaxhohet në mënyrë optimale rezerva ujore, me
qëllim parandalimin e përmytjeve në rrjedhën e poshtme të Lumit Bistricë; Të respektohet në
mënyrë strikte sasia e rrjedhës ekologjike dhe e nevojave të komunitetit për ujtiqe apo
blegtori.

Periudha e vlefshmërisë: **5 vjet**



Kushtet e Lejes

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje;
2. Te respektohen kushtet higjieno sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth;
3. Përdoruesi i ujit është i detyruar të vendosë matës ujit me shpenzimet e veta sipas rregullave që vendosin autoritetet e ujit;
4. Në rastet kur uji përdoret si produkt ushqimor, procedurat e prodhimit duhet të jenë konform rregullave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
5. Burimi ujqor të shfrytëzohet nga zotëruesi i lejes;
6. Brenda 2 muajve nga pajisja me leje, subjekti duhet të fillojë veprimtarinë për të cilën është pajisur me leje;
7. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejtë ose si pasojë, dëmtimin e burimit ujqor;
9. Subjekti të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse;
10. Subjekti të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim lidhur me mënyrën e përdorimit të burimit ujqor;
11. Për shkeljen e kushteve të lejes, do të merren masa në përputhje me Kreun XIX të Ligjit nr. 111/2012;
12. Zotëruesi i lejes paguan shpenzimet administrative dhe tarifën për ujin e shfrytëzuar, bazuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Ndryshimi ose anulimi i lejes

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar, kur:

1. Përfutuesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara me sipër;
2. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes bën azhurnimet përkatëse lidhur me burimin konform ndryshimit të planeve të burimeve ujore, ndryshim i cili prek edhe burimin ujqor, objekti i kësaj leje;
3. Kushtet e dhënies së lejes kane ndryshuar;
4. Burimi ujqor është drejt shterimit;
5. Aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit;
6. Në qoftë se për shkak të forcave madhore ndodhin ndryshime në prurjen, cilësinë, kufijtë e burimit, etj, dhe këto ndryshime sjellin pamundësinë e përdorimit të tij nga zotëruesi i lejes, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet organit kompetent, që i ka dhënë lejen, për ta anuluar atë;
7. Ka ndryshime të legjislacionit përkatës në fushën e ujërave dhe që prekin drejtpërdrejtë kushtet e kësaj leje.